

Organizata për siguri dhe bashkëpunim në Evropë MISIONI NË KOSOVË

Raporti 01/2006 i Shtyllës së III-të (OSBE) Mbi monitorimin e Kuvendit të Kosovës 24 dhjetor 2005 – 10 mars 2006

Titujt kryesor

- Kuvendi zgjedh Kryetarin e ri të Kosovës pas vdekjes së Kryetarit Rugova
- Kuvendi zgjedh Kryeministrin e ri dhe Qeverinë pas dorëheqjes së Kryeministrit Kosumi
- Zgjedhet Kryetari i ri i Kuvendit
- Kuvendi diskuton për çështjen e Gërmisë tre muaj pas dorëzimit të kërkesës nga ORA, çështja kthehet në Kryesi për shqyrtim të mëtejshëm
- Përdoret procedura e parregullt për emërimin e anëtarëve në këshillin e Agjencisë kundër korrupsionit
- Miratohet projektligji për të drejtat dhe statusin e veteranëve të luftës së UÇK-së, invalidëve dhe familjeve të dëshmorëve, dhe viktimave civile të luftës, por mbetet e paqartë se kur do të jenë në dispozicion mjetet buxhetore për zbatimin e tij
- PDK-ja thërret Ministren e Shërbimeve Publike në interpelancë, Ministrja refuzon kërkesën me pohimin se nuk është e formuluar saktë dhe se është pa arsytim të qëndrueshëm

1. Sfond

Raporti i dyzetetretë i monitorimit është hartuar në përputhje me pikëpamjet referuese të Shtyllës së tretë të UNMIK-ut për themelimin e institucioneve (OSBE) dhe monitorimin e Kuvendit të Kosovës prej 26 nëntor 2002 dhe bazohet në pajtueshmërinë me Rregulloren e re të punës të miratuar në fund të seancës plenare më 20 maj 2005.

Gjatë periudhës raportuese, Kuvendi ka mbajtur dy seanca të rregullta plenare, më 19-20 janar/14-15 shkurt, dhe më 23 shkurt, si dhe gjashtë mbledhje të rregullta të Kryesisë, më 12 janar, 7, 9 dhe 20 shkurt, dhe 7 dhe 9 mars. Më 22 janar, Kuvendi ka mbajtur një seancë përkujtimore në përkujtim të Kryetarit të Kosovës Ibrahim Rugova, i cili kishte ndërruar jetë një ditë më parë. Më 10 shkurt, Kuvendi ka mbajtur seancë të posaçme për ta zgjedhur Kryetarin e ri të Kosovës, z. Fatmir Sejdiu (LDK). Seanca plenare e 19 janarit është ndërprerë me rastin e vdekjes së Kryetarit Rugova më 21 janar, dhe ka vazhduar më 14 shkurt, pas përfundimit të periudhës zyrtare të zisë dhe pas zgjedhjes së Kryetarit të ri të Kosovës. Më 10 mars, Kuvendi ka mbajtur seancë të posaçme plenare për zgjedhjen e Kryeministrit të ri dhe kabinetit qeveritar dhe zëvendësimin¹ e Kryetarit të Kosovës dhe një anëtar të Kryesisë. Të dhjetë komisionet, si dhe nënkomisioni për të drejtat e njeriut, barazi gjinore, peticione dhe ankesa publike, i kanë mbajtur mbledhjet gjatë kësaj periudhe.² Shtylla e III-

¹ Ekzistonin mospajtime të shumta në mesin e deputetëve lidhur me atë se a duhej përdorur termin “zëvendësim” apo “shkarkim” të Kryetarit të Kuvendit. Ky raport do të përdor fjalën që paraqitet në rendin zyrtar të ditës të seancës plenare: “zëvendësim”.

² Komisioni për çështje gjyqësore, legjislativë dhe Kornizë Kushtetuese është takuar më 29 dhjetor, 16 janar, 8, 20 dhe 27 shkurt, dhe 6 mars derisa Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe kthim është takuar më 30 dhjetor, 9 dhe 16 janar, dhe 8 shkurt, dhe 8 mars. Komisioni për buxhet dhe financa është takuar më 29 dhjetor, 11 janar, 7 shkurt, dhe 1, 2 dhe 7 mars, derisa Komisioni për ekonomi, tregti, industri, energji, transport dhe telekomunikacion është takuar më 12 janar, 7, 21 dhe 28 shkurt. Komisioni për shëndetësi, punë, mirëqenie sociale dhe personat e zhdukur është takuar më 28 dhjetor, 12 dhe 17 janar, 13 dhe 22 shkurt, dhe 2 mars, derisa Komisioni për arsim, shkencë, teknologji, kulturë, rini dhe sport është takuar më 30 janar, 6, 7, 17, 20, 21 dhe 22 shkurt. Komisioni për bujqësi, pylltari, zhvillim rural, ambient dhe planifikim hapësinor është takuar më 17 janar, 7, 21 dhe 22 shkurt, dhe 1 mars,

të (OSBE) i ka monitoruar seancat plenare dhe mbledhjet e Kryesisë, si dhe 43 prej 50 mbledhjeve të komisioneve dhe tre dëgjime publik.³

2. Vështrim

Seancën plenare të Kuvendit të Kosovës të mbajtur më 19-20 janar dhe 14-15 shkurt e kryesoi Kryetari i Kuvendit Nexhat Daci (LDK) dhe bashkëkryesoi anëtari i Kryesisë z. Naim Maloku (AAK).

- Tetëdhjetë e tetë, 73, 91 dhe 76 deputetë ishin të pranishëm më 19 janar, 20 janar, 14 shkurt, përkatësisht 15 shkurt.⁴
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të 19-20 janarit dhe 14-15 shkurtit:
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për inspektoratin shëndetësor (Projektligji është miratuar me shumicë votash për dhe pa vota kundër.)
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për edukimin parashkollor (Projektligji është miratuar me shumicë votash për dhe pa vota kundër.⁵)
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për miniera dhe minerale (Projektligji është miratuar me shumicë votash për dhe pa vota kundër.)
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për metrologjinë (Projektligji është miratuar me shumicë votash për dhe 13 vota kundër.)
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për Radio Televizionin e Kosovës (Projektligji është miratuar me 73 vota për dhe katër vota kundër.)
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për provimin e jurisprudencës (Projektligji është miratuar me 79 vota për dhe dy vota kundër.)
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për veprimtarinë botuese dhe librin (Projektligji është miratuar në parim me 68 vota për dhe dy vota kundër.)
 - Raporti i Komisionit për çështje gjyqësore, legjislative dhe Kornizë Kushtetuese lidhur me komentet e UNMIK-ut në Ligjin për familjen (Rekomandimet nga ky raport janë miratuar me 64 vota për dhe 13 vota kundër, ndërsa Ligji në tërësi, së bashku me amandamentet e rekomanduara, është miratuar me 63 vota për dhe pesë vota kundër.⁶)

derisa Komisioni për gatishmëri emergjente është takuar më 12 janar dhe 22 shkurt. Komisioni për shërbime publike, administratë lokale dhe media është takuar më 3 dhe 11 janar, 6, 8, 17 dhe 24 shkurt, derisa Komisioni për bashkëpunim ndërkombëtar dhe integritet euroatlantike është takuar më 20 shkurt. Nënkomisioni për të drejtat e njeriut, barazi gjinore dhe peticione e ankesa publike është takuar më 12 janar dhe 27 shkurt. Komisioni për arsim, shkencë, teknologji, kulturë, rini dhe sport ka mbajtur një dëgjim publik të projektligjit për institucionet e kulturës më 13 shkurt, derisa Komisioni për çështje gjyqësore, legjislative dhe Kornizë Kushtetuese ka mbajtur dëgjim publik të projektligjit kundër shpifjes dhe fyerjes më 28 shkurt. Komisioni për ekonomi, tregti, industri, energji, transport dhe telekomunikacion ka mbajtur dëgjim publik të projektligjit për shpronësim më 7 mars.

³ Komisioni për çështje gjyqësore, legjislative dhe Kornizë Kushtetuese më 29 dhjetor, 16 janar, 8, 20 dhe 27 shkurt, dhe 6 mars; Komisioni për të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe kthim më 30 dhjetor, 9 dhe 16 janar, 8 shkurt dhe 8 mars; Komisioni për buxhet dhe financa më 29 dhjetor, 11 janar, 7 shkurt, dhe 1 dhe 2 mars; Komisioni për ekonomi, tregti, industri, energji, transport dhe telekomunikacion më 12 janar, 7, 21 dhe 28 shkurt; Komisioni për shëndetësi, punë, mirëqenie sociale dhe personat e zhdukur më 28 dhjetor, 12 dhe 17 janar, 13 dhe 22 shkurt; Komisioni për arsim, shkencë, teknologji, kulturë, rini dhe sport më 30 janar, 6, 7, 17, 20, 21 dhe 22 shkurt; Komisioni për bujqësi, pylltari, zhvillim rural, ambient dhe planifikim hapësinor më 7 dhe 22 shkurt; Komisioni për gatishmëri emergjente më 12 janar dhe 22 shkurt; Komisioni për shërbime publike, administratë lokale dhe media më 3 dhe 11 janar, 6, 8, 17 dhe 24 shkurt; Komisioni për bashkëpunim ndërkombëtar dhe integritet euroatlantike më 20 shkurt; Nënkomisioni për të drejtat e njeriut, barazi gjinore dhe peticione e ankesa publike më 12 janar dhe 27 shkurt; Dëgjimin publik të projektligjit për Institucionet e kulturës më 13 shkurt; Dëgjimin publik të projektligjit kundër shpifjes dhe fyerjes më 28 shkurt; dhe Dëgjimin publik të projektligjit për shpronësim më 7 mars.

⁴Këto janë shifrat e njoftuara nga Kryetari i Kuvendit në fillim të secilës ditë të seancës plenare.

⁵ Abstenimet nuk janë njoftuar, përveç nëse në raport është bërë e ditur në ndonjë mënyrë tjetër. Pasi që janë përdorur paisjet elektronike për votim, i tërë rezultati i votimit është treguar në ekranin në ballë të sallës plenare, por shifrat nuk mund të shihen nga pjesa e vëzhguesve në fund të sallës plenare.

- Shqyrtimi i parë i projektligjit për ndërmjetësim (Projektligji është miratuar në parim me 69 vota për dhe një votë kundër.)
- Shqyrtimi i parë i projektligjit për konfliktet administrative (Projektligji është miratuar në parim me 65 vota për, dy vota kundër dhe një abstenim.)
- Shqyrtimi i parë i projektligjit kundër shpifjes dhe fyerjes (Projektligji është miratuar në parim me 51 vota për, tetë vota kundër dhe katër abstenime.)
- Shqyrtimi i parë i projektligjit për ditën e dëshmorëve (Projektligji është miratuar në parim me 73 vota për.)
- Debat sipas kërkesës së grupit parlamentar ORA⁷
- Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë së Kosovës për emërimet në Bordin e pavarur të ankesave (Kandidatët janë miratuar me 51 vota për dhe 30 vota kundër.)
- Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë së Kosovës për emërimet në Agjencinë e prokurimit publik (Kandidatët janë miratuar me 53 vota për dhe 28 vota kundër.⁸)
- Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë së Kosovës për emërimet në Bordin rregullativ të energjisë (Kandidatët janë miratuar me 59 vota për dhe 19 vota kundër.)
- Shqyrtimi i propozimit të Qeverisë së Kosovës për emërimet në këshillin e Agjencisë kundër korrupsionit (Shefat e grupeve parlamentare janë pajtuar ta shtyjnë këtë pikë për seancën plenare të datës 23 shkurt për t'u mundësuar grupeve parlamentare që të arrijnë marrëveshjen për ndarjen e tre vendeve në këshillin e Agjencisë, të cilët i emëron Kuvendi.)
- Shqyrtimi i rekomandimeve të Komisionit për buxhet lidhur me buxhetin për vitin 2006 të Autoritetit rregullativ të telekomunikacionit
- Përgjigja e Ministres Melihate Tërmmkollit në mocionin për interpelancë të grupit parlamentar të PDK-së
- Propozimi i rendit të ditës për seancën plenare të 23 shkurtit 2006⁹

Seancën plenare të Kuvendit të Kosovës të mbajtur më 10 shkurt e kryesoi Kryetari i Kuvendit Nexhat Daci (LDK), së bashku me anëtarët e tjerë të Kryesisë.

- Njëqind e dhjetë deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare të 10 shkurtit.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të 10 shkurtit:
 - Zgjedhja e Kryetarit të Kosovës (Z. Fatmir Sejdiu (LDK) është zgjedhur Kryetar i Kosovës në rrethin e tretë të votimit me 80 vota për dhe dymbëdhjetë vota kundër.)¹⁰

Seancën plenare të Kuvendit të Kosovës të mbajtur më 23 shkurt e kryesoi Kryetari i Kuvendit Nexhat Daci (LDK) dhe bashkëkryesoi anëtari i Kryesisë z. Gazmend Muhaxheri (ORA).

⁶ Udhëzimet e mëhershme të UNMIK-ut për ndryshimin ose plotësimin e ligjeve, pasi të jenë miratuar nga Kuvendi, por ende pa u shpallur nga PSSP-ja, kanë hasur në kundërshtime serioze nga ana e Kuvendit, për shkak të mungesës së procedurës së duhur për miratimin e ndryshimeve të tilla. Shiko raportet 08/2003 dhe 09/2003 të Shtyllës së III-të (OSBE).

⁷ ORA ka kërkuar debat për "Qendrën adminstrativo-protokollare" në Parkun e Gërmisë dhe keqmenaxhimin e buxhetit të Kosovës. Tema e debatit nuk është shfaqur në rendin e ditës me shkrim.

⁸ Kuvendi në vendimin e tij ka përfshirë vërejtjen se kandidati i dytë në listë nuk ishte i kualifikuar për pozitën në fjalë dhe se duhet të zëvendësohej me një kandidatë më të kualifikuar. Ky konkluzion është sjellur gjatë diskutimit që i ka paraprirë votimit të listës së kandidatëve.

⁹ Në fillim të seancës plenare të 19 janarit, seanca e ardhshme plenare ishte planifikuar për 9 shkurt. Pas vdekjes së Kryetarit Rugova dhe pesëmbëdhjetë ditëve pasuese të zisë, seanca është ndërprerë deri më 14 shkurt, ndërsa seanca e ardhshme është shtyrë për 23 shkurt.

¹⁰ Shtatëmbëdhjetë fletëvotime janë shpallur "të pavlefshme": këto me siguri ishin abstenimet.

- Nëntëdhjetë e një deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare të 23 shkurtit.¹¹
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të 23 shkurtit:
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për aftësimin dhe trajnimin profesional (Projektligji është miratuar me 74 vota për dhe gjashtë vota kundër.)
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për trashëgiminë kulturore (Projektligji është tërhequr nga rendi i ditës me kërkesë të dorëzuar me shkrim nga Kryeministri Bajram Kosumi.)
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për themelimin e Institutit Gjyqësor të Kosovës (Projektligji është miratuar me 74 vota për dhe tri vota kundër.)
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për kujdesin mjekësor emergjent (Projektligji është miratuar me 80 vota për dhe dy vota kundër.)
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për markat tregtare (Projektligji është miratuar me 76 vota për dhe pesë vota kundër.)
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për ushqimin (Projektligji është tërhequr nga rendi i ditës për t'u dhënë më shumë kohë komisioneve përkatëse ta shqyrtojnë atë.)
 - Shqyrtimi i dytë i projektligjit për të drejtat dhe statusin e veteranëve të luftës së UÇK-së, invalidëve dhe familjeve të dëshmorëve, dhe viktimave civile të luftës (Projektligji është miratuar me 80 vota për dhe dy vota kundër.)
 - Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për bujqësi, pylltari, zhvillim rural, ambient dhe planifikim hapësinor lidhur me projektligjin për banim (Rekomandimi i Komisionit që projektligji të kthehet në Qeveri për ripunim të mëtutjeshëm është miratuar me 68 vota për dhe tri vota kundër.)
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për botimin e teksteve shkollore, mjeteve mësimore, lekturës shkollore dhe dokumentacionit pedagogjik (Projektligji është miratuar në parim me 72 vota për dhe tri vota kundër.)
 - Shqyrtimi i parë i projektligjit për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera (Projektligji është miratuar në parim me 77 vota për dhe dy vota kundër.)
 - Shqyrtimi i propozimit për emërimet në këshillin e Agjencisë kundër korrupsionit (Tre kandidatët e parë të votuar janë shpallur të zgjedhur. Lista në tërësi është miratuar me 44 vota për dhe 35 vota kundër. Shiko pikën e dytë nën "Procesi i votimit".)
 - Propozimi i Kryesisë së Kuvendit për rendin e ditës për seancën plenare të 16 marsit

Seancën plenare të Kuvendit të Kosovës të mbajtur më 10 mars e kryesoi së pari anëtari i Kryesisë Naim Maloku (AAK), ndërsa më pas Kryetari i sapozgjedhur i Kuvendit Kolë Berisha (LDK).

- Njëqind e shtatë deputetë ishin të pranishëm në seancën plenare të 10 marsit.
- Pikat kryesore të rendit të ditës të seancës plenare të 10 marsit:
 - Shqyrtimi i propozimit të grupit parlamentar të LDK-së për zëvendësimin e anëtarit të Kryesisë dhe Kryetarit të Kuvendit Nexhat Daci me z. Kolë Berisha, si dhe të z. Fatmir Sejdiu me z. Sabri Hamiti për anëtar të Kryesisë (Zëvendësimi është kryer me një votim, në të cilin shumica e deputetëve votoi për, dy votuan kundër, ndërsa katër abstenuan.)
 - Zgjedhja e Kryeministrit dhe Qeverisë së Kosovës (Kryeministri i ri Agim Çeku (AAK) dhe Qeveria janë zgjedhur me 65 vota për, 33 vota kundër dhe pesë abstenime.)

¹¹Kjo është shifra e njoftuar nga Kryetari i Kuvendit në fillim të seancës plenare.

3. Punimet dhe praktikat parlamentare në seancat e Kuvendit

Rendi i ditës

- Në fund të seancës plenare të 19-20 janarit/14-15 shkurtit është paraqitur për miratim rendi i ditës për seancën plenare të 23 shkurtit. Kryetari i Kuvendit tha se z. Emrush Xhemajli (LPK) kishte dorëzuar një kërkesë që Kuvendi në seancën plenare të radhës të informohet lidhur me punën e delegacionit të Kosovës për bisedimet për decentralizimin. Kryetari i Kuvendit u përgjigj se kërkesa dukej mjaft e arsyeshme. Të dytë, ORA dhe grupi parlamentar për Integrim u përpoqën gojarisht të bëjnë propozime për rendin e ditës në atë moment, mirëpo Kryetari i Kuvendit nuk u lejoi, duke argumentuar se nuk i kishin dorëzuar me shkrim më parë.

Në fillim të seancës plenare të 23 shkurtit, z. Jakup Krasniqi (PDK) edhe njëherë në emër të grupit të tij parlamentar kërkoi që Kuvendi të fillojë të mbajë seanca plenare javore, duke argumentuar se dinamika e punës së Kuvendit me seanca mujore është në shpërputhje me zhvillimet e rëndësishme të kohës. Ai propozoi që Kuvendi t'i diskutonte atë ditë dy çështje të tilla - procesi i privatizimit dhe kritikën e bashkësisë ndërkombëtare drejtuar IPVQ-ve për përmbushjen e ngadalshme të Standardeve - si çështje të ngutshme. Kryetari i Kuvendit u përgjigj se Kryesia do ta shqyrtonte planin për seancat javore plenare në mbledhjen e saj të ardhshme, dhe se LDK-ja gjithashtu kishte shumë propozime për diskutimin e çështjeve në seanca javore. Sidoqoftë, ai komentoi se çështja e Standardeve dhe privatizimi nuk ishin aq të ngutshme për t'i votuar menjëherë. Z. Berat Luzha (PDK) ia rikujtoi Kuvendit se më 19 janar kishte ngritur çështjen e rrugës së mbyllur që shpie për Shkup, duke theksuar se Qeveria e ka angazhuar një kompani të vogël dhe e cila nuk ka kapacitete ta pastrojë rrugën. Z. Luzha propozoi që, meqë rruga ende nuk ishte e hapur edhe pas më shumë se një muaji, kjo çështje të diskutohet urgjentisht në Kuvend. Kryetari i Kuvendit u përgjigj se Kryesia e ka diskutuar këtë çështje në mbledhjen e saj të fundit dhe i ka përkrahur shqetësimet e z. Luzha, por se nuk ishte e mundur të merrej ndonjë vendim për këtë çështje vetëm në bazë të shqetësimeve dhe pa pasur më shumë informata. Ai shtoi se ata që janë përgjegjës e kanë sqaruar çështjen në media dhe se nuk është çështje të cilën mund ta zgjidhte Kuvendi.

Znj. Gjylnaze Sylja (AAK) tha se grupi i saj parlamentar e përkrahte propozimin e mëhershëm të z. Emrush Xhemajli që delegacioni i Kosovës për bisedimet për decentralizimin të raportojë në Kuvend, dhe propozoi që të mbahet një seancë e posaçme plenare për këtë çështje para seancës plenare të 16 marsit. Znj. Teuta Sahatqija (ORA) e shprehu përkrahjen e grupit të saj parlamentar për propozimet e z. Krasniqi, z. Luzha dhe z. Rrahmani.¹² Z. Emrush Xhemajli tha se i përkrahte deklaratat e AAK-së dhe ORA-s, duke shtuar se është në interesin e delegacionit të diskutojë për punën e vetë me Kuvendin. Z. Ramë Buja (PDK) foli në favor të kërkesës së z. Luzha për të diskutuar për rrugën e mbyllur, duke theksuar se Ministri përkatës ishte i pranishëm dhe se mund të kërkohej prej tij që të jepte informata lidhur me atë se pse rruga ende nuk ishte pastruar. Z. Buja shtoi se grupet tjera parlamentare e kanë përkrahur propozimin e z. Krasniqi dhe propozoi se prandaj debatet mund të mbaheshin në atë seancë. Kryetari i Kuvendit tha se ai tashmë i kishte dhënë përgjigje z. Krasniqi dhe se nuk kishte asgjë për të shtuar, dhe e shpërfilli kërkesën për ta ftuar ministrin që të jepë informata.

Në fund të seancës plenare të 23 shkurtit, gjersa paraqitej për miratim rendi i ditës për seancën e ardhshme plenare, z. Jakup Krasniqi (PDK) e përsëriti kërkesën e tij të mëhershme për të diskutuar sa më shpejt që të jetë e mundur për çështjen e përmbushjes së Standardeve dhe privatizimit në seancë plenare. Kryetari i Kuvendit rikujtoi se Kuvendi tashmë ishte mbajtur një debat "joproduktiv" për përmbushjen e Standardeve. Ai kërkoi që propozimet t'i dorëzohen Kryesisë për marrjen e vendimit. Z. Sabri Hamiti (LDK) tha se propozimet e PDK-së ishin të arsyeshme dhe shtoi se Ministri Dugolli e kishte informuar atë gjatë pauzës se do të ishte i gatshëm të përgjigjet në interpelancë për çështjen e privatizimit. Z. Krasniqi rikujtoi se PDK kishte dorëzuar dy mocione për interpelancë, në të cilët ministrat përkatës nuk janë përgjigjur.¹³

¹² Shiko pikën e dytë nën "Qasja dhe pjesëmarrja e barabartë e komuniteteve".

¹³ Shiko paragrafin e titulluar "Interpelanca" fq. 12-13, poashtu raportin 08/2005 të Shtyllës së III-të (OSBE).

Z. Hydajet Hyseni (PDK) theksoi se mosrespektimi i pyetjeve parlamentare flet keq për ministrat. Z. Alush Gashi (LDK) tha se grupi i tij parlamentar është për transparencë të plotë dhe se prandaj Qeveria duhet të raportojë në Kuvend për përmbushjen e Standardeve dhe privatizimin. Ai kërkoi që të dy temat të përgatiten mirë, duke pasur material të mjaftueshëm, dhe se debatet duhet të jenë të plota.

Në rastet e përmendura më sipër, rendet e ditës të seancave plenare janë paraqitur në Kuvend për miratim në fund të seancave të mëparshme plenare, siç kërkohet në rregullën 23.1, në dallim nga të gjitha seancat tjera plenare në përafërsisht dy vitet e kaluara. Kjo paraqet një përmirësim të madh në krahasim me seancat e mëparshme, me ç'rast rendet e ditës bëheshin të njohur vetëm disa ditë më parë dhe rrallë miratoheshin nga Kuvendi.

Rregulla 29.1 parasheh që "në çdo seancë plenare, deputeti në marrëveshje me Kryetarin e Kuvendit, mund të propozojë që Kuvendi të shqyrtojë menjëherë një çështje urgjente. Nëse Kryetari i Kuvendit konsideron se çështja menjëherë meriton t'i kushtohet vëmendja e Kuvendit, deputetit në fjalë i mundëson të japë propozime në Kuvend, që pastaj do t'i vëjë në votim." Sipas rregullës 29.1, ishte në të drejtën e Kryetarit të Kuvendit kur ka vendosur se çështjet e propozuara nuk "e meritojnë vëmendjen e menjëhershme të Kuvendit." Sidoqoftë, një çështje e tillë ende mund t'i propozohet formalisht Kryesisë, e cila, sipas rregullës 6.5, duhet ta vendosë në rendin e ditës të seancës plenare brenda tri javësh pune, me kusht që mocioni të përkrahet nga të paktën gjashtë deputetë.

Numri i madh i çështjeve shtesë që u propozuan nga grupet parlamentare thekson nevojën që Kuvendi sa më shpejt t'i kthehet mbajtjes së seancave javore plenare. Zbatimi i Planit të punës të Kuvendit pa vonesa të mëtejshme do të ishte i dobishëm në këtë aspekt.

Shpërndarja e dokumentave

- Projektligji për ndërmjetësim është shpërndarë më 2 dhjetor 2005; projektligji për konfliktet administrative më 12 dhjetor; ndërsa projektligji kundër shpifjes dhe fyerjes, dhe projektligji për ditën e dëshmorëve janë shpërndarë më 19 dhjetor. Andaj, projektligjet janë shpërndarë 30, 24, përkatësisht 19 ditë pune para shqyrtimit të tyre të parë në seancën plenare të 20 janarit 2006. Projektligji për botimin e teksteve shkollore, mjeteve mësimore, lektyrës shkollore dhe materialit pedagogjik është shpërndarë më 23 dhjetor 2005, ndërsa projektligji për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera është shpërndarë më 29 dhjetor. Andaj, projektligjet janë shpërndarë 39, përkatësisht 33 ditë pune para shqyrtimit të tyre të parë në seancën plenare të 23 shkurtit.

Rregulla 35.1, parasheh që shqyrtimi i parë i projektligjit të bëhet jo më parë se dhjetë ditë pune dhe as më shumë se tri javë pune nga dita e shpërndarjes së tij. Meqë Kuvendi i mban seancat plenare vetëm një herë në muaj, është jashtëzakonisht e vështirë të caktohet shqyrtimi i parë i secilit projektligj jo më herët se dhjetë ditë pune dhe jo më vonë se tri javë pune nga dita e shpërndarjes së tij, siç kërkohet me Rregulloren e Kuvendit. Nëse, për shembull, një projektligj i dorëzohet Kuvendit dhe shpërndahet gjatë javës së tretë të muajit dhe seanca plenare mbahet gjatë javës së katërt, siç parashihet me Rregulloren e punës, projektligji nuk mund të shkojë në shqyrtim të parë gjatë po atij muaji, sepse deputetët e Kuvendit nuk do të kishin dhjetë ditë për ta studiuar projektligjin para shqyrtimit të parë. Nëse shqyrtimi i parë bëhet gjatë javës së katërt të muajit të ardhshëm, pasi të kenë kaluar përafërsisht pesë javë pune nga shpërndarja e projektligjit deri në shqyrtimin e tij të parë, atëherë shkelet Rregullorja. Kufizimi maksimal prej tri javë pune nga shpërndarja e projektligjit deri në shqyrtimin e tij të parë, që është shtuar nga vetë Kuvendi gjatë ripunimit të Rregullores së punës, është i realizueshëm vetëm nëse Kuvendi mban seanca plenare çdo javë ose së paku çdo dy javë.

Debatet

- Më 14 shkurt, në vazhdimin e seancës plenare të 19 janarit, Kryetari i Kuvendit i hapi punimet duke njoftuar se debati i kërkuar nga ORA do të ishte i plotë dhe pa kufizime kohore. Znj. Teuta Sahatqija (ORA) tha se kërkesa e grupit të saj parlamentar, e dorëzuar më 7 nëntor, përmbante debatin për dy çështje: Qendrën administrativo-protokollare në Gërmë dhe keqmenaxhimin e

buxhetit të Kosovës, dhe theksoi se rregulla 23.5 lejon që më tepër se një çështje të diskutohen në seancë të jashtëzakonshme.¹⁴ Kryetari i Kuvendit u përgjigj se rendi i ditës është miratuar në kohë të duhur dhe se debati do të vazhdonte në përputhje me këtë. Z. Gazmend Muhaxheri (ORA) i është dhënë fjala për ta hapur debatin, me ç'rast ai numëroi shumë çështje të cilat, sipas tij, e vëjnë në dyshim ligjshmërinë e projektit në Gërmi, duke filluar me mungesën e dukshme të ndonjë vendimi zyrtar të nxjerrë nga Kuvendi për ndërtimin e qendrës në Gërmi, dhe duke përfshirë parregullsitë në procesin tenderues dhe dhënien e lejës për ndërtim. Kryetari i Kuvendit e ftoi më pas Sekretarin e Kuvendit, z. Isuf Demaj, që t'i përgjigjet akuzave. Z. Nazim Jashari (ORA) thirri pandërprerë për nja dy minuta se Sekretari i Kuvendit nuk mund të flasë para Kuvendit në seancë plenare, dhe grupi parlamentar i PDK-së e lëshoi sallën, i përcjellur nga shumica e deputetëve të ORA-s. Të dy grupet parlamentare u kthyen në sallë pasi që z. Demaj e përfundoi deklaratën. Z. Jakup Krasniqi (PDK) më vonë bëri vërejtje se Kuvendi është dashur të vendosë a t'i lejojë apo jo Sekretarit të flasë në seancë. Kryetari i Kuvendit u përgjigj se asnjë dispozitë e ndonjë dokumenti ligjor që lidhet me punën e Kuvendit nuk e ndalon Sekretarin që ta marrë fjalën. Z. Fadil Geci (LDK) bëri gjatë debatit një sërë kritikash dhe akuzash kundër ORA-s dhe z. Veton Surroi, të cilat nuk ishin të lidhura me temën e debatit, mirëpo Kryetari i Kuvendit nuk ia ka tërhequr vërejtjen.

Të gjithë deputetëve që kanë dëshiruar të marrin pjesë në debat u është lejuar të flasin lirshëm, gjë e cila është në pajtim me rregullën 12, mbi të drejtën e deputetëve që “në kushtet e barabarta me deputetët tjerë të marrin pjesë në të gjitha diskutimet e Kuvendit.” Kryetari i Kuvendit nuk i parandaloi deputetët e opozitës që të bëjnë deklaratatë të pafavorshme për të, mirëpo gjithashtu nuk ua tërhoqi vërejtjen as deputetëve si z. Geci, i cili ishte “larguar nga çështja që ishte e shtruar për diskutim”, siç kërkohet në rregullën 22.10. Edhe pse Kryetari i Kuvendit e kryesoi seancën në mënyrë mjaft neutrale, do të mund të ketë qenë megjithatë më e përshtatshme për të, si palë e interesuar, sikur të kishte hequr dorë nga kryesimi i kësaj pjese të seancës.

Në mungesë të dispozitave që rregullojnë pjesëmarrjen e shërbyesve civil në seancat plenare të Kuvendit, çështja është dashur t'i dërgohet Kryesisë për shqyrtim para debatit në seancë. Rregulla 6.2 parasheh që Kryesia “merr pëlqimin nga grupet parlamentare për formën dhe kohëzgjatjen e diskutimit për një çështje të caktuar të punës.”

Procesi i votimit

- Kishte kuorum për të gjitha votimet në seancat plenare në fjalë.
Kjo është në pajtim me nenin 9.1.32 të Kornizës Kushtetuese dhe rregullën 31.1, e cila parasheh që për marrjen e vendimeve duhet të jenë të pranishëm shumica e deputetëve.
- Gjatë debatit për çështjen e Gërmisë më 14 shkurt, z. Jakup Krasniqi tha se PDK kishte kërkuar kohë më parë formimin e komisionit hetimor parlamentar për të hetuar korrupsionin e mundshëm të Qeverisë dhe se PDK-ja e përkrahte formimin e komisionit hetimor edhe tani për të shqyrtuar çështjen e Gërmisë. Kërkesa për formimin e komisionit parlamentar është përsëritur edhe nga disa deputetë tjerë, duke përfshirë z. Hydajet Hyseni (PDK) dhe z. Ylber Hysa (ORA). Si përgjigje ndaj pohimit të Sekretarit të Kuvendit se Kryesia më 6 maj 2003 kishte marrë vendim për ndërtimin e qendrës në Gërmi, z. Xhavit Haliti (PDK) dhe z. Hydajet Hyseni (PDK) pohuan se kjo çështje kurrë nuk është diskutuar në Kryesi. Znj. Gjylnaze Sylja (AAK) gjithashtu tha se Kryesia nuk është konsultuar asnjëherë për këtë çështje, por shtoi se kur është miratuar buxheti nga Kuvendi dhe PSSP-ja, Këshilli ekonomik dhe fiskal nuk ka ndërhyrë. Ajo argumentoi se në Kuvend mungonte mbikëqyrja financiare dhe propozoi themelimin e një komisioni ad hoc, të përbërë nga shefat e grupeve parlamentare, i cili do të rekomandonte

¹⁴ “Kryesia thërret, me nismën e vet, ose si përgjigje ndaj kërkesës së bërë nga Kryeministri, nga një ose më shumë grupe parlamentare, që përfaqësojnë jo më pak se një të tretën, përkatësisht 40 deputetë në Kuvend, seancën e jashtëzakonshme të Kuvendit, në mënyrë që ta trajtojë një çështje të ngutshme. Kërkesa duhet të përmbajë çështjen ose çështjet që do të shqyrtohen si dhe arsyet pse ato konsiderohen të ngutshme dhe të rëndësishme që në mënyrë të tillë të shqyrtohen në Kuvend. Në raste të tilla shqyrtohen vetëm çështjet që përbëjnë bazën e kërkesës.”

reformat e nevojshme dhe do të monitoronte funksionimin e Kuvendit. Z. Ferid Agani (Grupi për Integrim/PD) propozoi, gjatë debatit, që të bëhej një pauzë me qëllim që shefat e grupeve parlamentare të konsultoheshin me njëri-tjetrin për përmbylljen e debatit. Z. Alush Gashi (LDK) dhe z. Sabri Hamiti (LDK) propozuan që të kërkohet nga Kryesia ta hetojë çështjen dhe t'i raportojë më pas Kuvendit. Z. Veton Surroi (ORA) gjithashtu kërkoi pauzë për konsultime ndërmjet shefave të grupeve parlamentare. Përkundër kundërshtimeve të zëshme të ORA-s, kryesuesi nuk e pranoi kërkesën për pauzë, por i vëri në votim të dy propozimet: raportimin e Kryesisë në Kuvend apo formimin e komisionit hetimor. Propozimi i LDK-së që Kryesia t'i raportojë Kuvendit për çështjen në fjalë është miratuar me shumicën e votave.

Gjatë debatit për çështjen e Gërmisë janë dhënë tre propozime të ndryshme për veprimet mëtejshme, një nga ORA dhe PDK-ja, një nga AAK-ja dhe një nga LDK-ja. Elementet e propozimeve të ndryshme kanë mundur të kombinohen në mënyrë që të arrihej konsenzusi ndërmjet grupeve parlamentare. ORA-s, si grup parlamentar që ka kërkuar debatin për çështjen e Gërmisë, është dashur t'i jipet mundësia të konsultohet, para votimit, me shefat e grupeve tjera parlamentare, siç kërkoi z. Surroi dhe Grupi për Integrim. Në vend të kësaj, ato kërkesa u shpërfillën dhe Kuvendi papritmas është ftuar të deklarohej ndërmjet propozimit të LDK-së, në njërin anë, dhe propozimit të ORA-s dhe PDK-së, në anën tjetër. Propozimi i AAK-së nuk është vënë në votim.

- Në seancën plenare të 23 shkurtit, Kryetari i Kuvendit njoftoi se pesë grupe parlamentare kishin propozuar veçmas nga një përfaqësues, prej të cilëve tre duhet të zgjedheshin, për këshillin e Agjencisë kundër korrupsionit. Emërimet ishin si vijon: z. Sadudin Berisha (LDK), z. Gani Koci (PDK), z. Ymer Halimi (AAK), z. Saša Đokić (SDSKM)¹⁵ dhe z. Ferid Agani (Grupi për Integrim). Kryetari i Kuvendit e pyeti znj. Nekibe Kelmendi (LDK) nëse ajo, “si avokate”, kishte ndonjë rekomandim se si të bëhej votimi. Znj. Kelmendi u përgjigj se kandidatët duhet të votoheshin ndaras. Kryetari i Kuvendit e vëri në votim emërimin e z. Berisha, i cili mori 56 vota për dhe 20 vota kundër, dhe është shpallur si i zgjedhur. Z. Koci, i cili mori 42 vota për dhe 37 vota kundër, dhe z. Halimi, i cili mori 61 vota për dhe 17 vota kundër, gjithashtu u shpallën si të zgjedhur. Kryetari i Kuvendit më pas njoftoi se Kuvendi i kishte zgjedhur tre përfaqësues për këshillin e Agjencisë kundër korrupsionit, pa i vënë në votim emërimet për dy kandidatët tjerë. U dëgjuan reagime të zëshme nga deputetët ndaj njoftimit të tij, veçanërisht nga ata të ORA-s dhe Grupit për Integrim. Z. Gjergj Dedaj (Grupi për Integrim/PLK) tha se Kuvendi duhet të deklarohej për të gjithë pesë kandidatët, me ç'rast tre kandidatë me numrin më të madh të votave do të emëroheshin në këshillin e Agjencisë kundër korrupsionit, në vend se të diskriminoheshin dy kandidatët tjerë. Pas marrjes së këshillës procedurale, Kryetari i Kuvendit tha se “gati e pëlqeu” propozimin e z. Dedaj, por se kishte qenë i informuar se propozimi ishte “pa objekt”. Ai më pas e vëri në votim listën e tërësishme prej nëntë kandidatëve, e cila është miratuar me 44 vota për dhe 35 vota kundër.

Procedura e përdorur për zgjedhjen e tre kandidatëve për këshillin e Agjencisë kundër korrupsionit ishte shumë e parregullt dhe arbitrare, dhe i ka favorizuar kandidatët, emrat e të cilëve janë thirrur në fillim. Do të kishte qenë krejtësisht e mundshme për z. Đokić dhe z. Agani të fitojnë shumicën e votave, ndoshta edhe më tepër se kandidatët e tjerë që janë shpallur si të zgjedhur. Kuvendi është dashur të ketë mundësi që të deklarohej për të gjithë pesë kandidatët, me ç'rast tre kandidatë me numrin më të madh të votave do të zgjedheshin për këshillin e Agjencisë kundër korrupsionit. Pasi që as Korniza Kushtetuese as Rregullorja e punës së Kuvendit nuk përmbajnë dispozita shprehimore për votimin në mes një numri opcionesh, Kuvendi duhet të krijojë procedura për votimet më të ndërlikuara, siç është rasti i lartëpërmendur.

¹⁵ SDSKM dhe SLKM janë bashkuar joformalisht si grup parlamentar, edhe pse nuk është e qartë nëse këto subjekte janë deklaruar bashkarisht si grup parlamentar. Sidoqoftë, kjo mospërputhje e vogël nuk është e rëndësishme për temën e lartëpërmendur, pasi që emërimi në këshillin e Agjencisë kundër korrupsionit nuk varet nga të qenurit anëtar i ndonjë grupi parlamentar.

Procesi ligjvënës

- Në raportin e tij për projektligjin për të drejtat dhe statusin e veteranëve të luftës së UÇK-së, invalidëve dhe familjeve të dëshmorëve, dhe viktimave civile të luftës, Komisioni për buxhet ka rekomanduar që projektligji të zbatohet “kur të krijohen kushtet dhe mundësitë buxhetore të Buxhetit të Kosovës.” Gjatë shqyrtimit të dytë të projektligjit, znj. Flora Brovina (PDK) kërkoi sqarim nga Ministri për Punë dhe Mirëqenie Sociale për implikimet buxhetore, i cili, sipas saj, e kishte informuar Komisionin për shëndetësi, punë dhe mirëqenie sociale se ekzistojnë mjetet e nevojshme për zbatimin e ligjit. Ministri nuk e ka kërkuar fjalën, por as Kryetari i Kuvendit nuk ka kërkuar nga ai të përgjigjet në pyetjen e znj. Brovina. Z. Naser Osmani (LDK), kryesuesi i Komisionit për buxhet, e elaboroi rekomandimin e komisionit të tij dhe propozoi që në kreun “Dispozitat përfundimtare dhe kalimtare” të përfshihet një dispozitë e re, e cila do të parashihte që ligji të hyjë në fuqi “për shembull në vitin 2009.” Ministri për Ekonomi dhe Financa Haki Shatri e përkrahu propozimin e Komisionit për buxhet dhe tha se duhet të përfshihej në nenin 20 (“Ky Ligj hyn në fuqi pas miratimit në Kuvendin e Kosovës dhe shpalljes nga ana e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm”). Ministri Shatri shtoi se Buxheti tashmë i miratuar i Kosovës për vitin 2006 nuk përmban mjete për projektligjin në fjalë. Kryetari i Kuvendit u përgjigj se nuk ishte e nevojshme të debatohej më tej për projektligjin dhe se “me debat, projektligji është shtyrë gati tre vjet.” Ai theksoi se institucionet e Kosovës “duhet ta bëjnë maksimumin që të gjenden mjetet për zbatimin e ligjit, edhe nëse është vetëm një shumë e vogël,” dhe shtoi se Kuvendi i Kosovës duhej ta miratonte ligjin atë ditë, dhe ta plotësonte në atë mënyrë obligimin e vetë moral.

Diskutimi i lartpërmendur tregon qartë se ekzistonte nevoja për më tepër konsultime ndërmjet Kuvendit dhe Qeverisë para miratimit të ligjit.

Zgjedhja e Kryetarit të Kosovës

- Një seancë e posaçme plenare është mbajtur më 10 shkurt për zgjedhjen e Kryetarit të ri të Kosovës pas vdekjes së Kryetarit Ibrahim Rugova më 21 janar. Seanca është hapur me një fjalim të shkurtër hyrës nga Kryetari i Kuvendit Nexhat Daci (LDK), i cili me dashamirësi e kujtoi Kryetarin Rugova dhe tha se zgjedhja e Kryetarit të ri të Kosovës është çështje jopartiake dhe në interesin e të gjithë kosovarëve, dhe se Kryetari i ri do të jetë personalitet unifikues. Z. Kolë Berisha, nënkryetar i LDK-së, është ftuar ta paraqesë kandidatin e LDK-së për Kryetar, z. Fatmir Sejdiu. Pasi i bëri nderime të ndjerit z. Rugova, z. Berisha e propozoi z. Sejdiu dhe foli për veprimtarinë e tij politike dhe kualifikimet për këtë post. Z. Hashim Thaçi i është dhënë pastaj fjala, “si kryetar i partisë e cila ka tridhjetë vende në Kuvend.”¹⁶ Z. Thaçi i falënderoi të pranishmit për brengosjen e tyre rreth mospranisë së mundshme të tij në këtë seancë të rëndësishme plenare¹⁷ dhe mbajti një fjalim që thirrej në papërgjegjësitë e supozuara të koalicionit të tanishëm qeverisës, por theksoi se PDK-ja do të “vepronte pozitivisht” duke marrë pjesë në votim. Në dy rrethet e para të votimit z. Sejdiu mori 78, përkatësisht 77 vota për. Në rrethin e tretë të votimit, kur z. Sejdiu i nevojiteshin vetëm 61 vota për t’u zgjedhur Kryetar, ai i mori 80 vota për, numri i saktë i votave që nevojitej për t’u zgjedhur në dy rrethet e para. Në rrethin e tretë të votimit ishin 12 vota kundër dhe 17 fletëvotime “të pavlefshme”, këto me sa

¹⁶ Arsyetimi për t’i lejuar vetëm LDK-së dhe PDK-së të flasin para votimit rrjedh nga përkthimi i gabuar i nenit 9.2.8 të Kornizës Kushtetuese në gjuhën shqipe. Dispozita përkatëse thotë që “emërimi i Kryetarit të Kosovës kërkon mbështetjen e partisë që ka siguruar numrin më të madh të vendeve në Kuvend ose së paku të 25 deputetëve” (p.sh. një deputet i një partie më të vogël mund të propozohet për Kryetar nëse ai ose ajo e ka përkrahjen e së paku 25 deputetëve). Përkthimi në shqip nënkupton që cilido kandidat duhet ta ketë përkrahjen e partisë që ka të paktën 25 deputetë. Andaj, LDK-së dhe PDK-së u është dhënë fjala duke u bazuar në supozimin se ato ishin dy partitë e vetme të cilat mund të propozonin kandidatë për Kryetar. Mospërputhja në përkthim është e parëndësishme në këtë rast, meqë nuk pati kundërkandidatë të propozuar. Përkthimi i gabuar nuk reflektohet në Rregulloren e punës së Kuvendit, e cila në verzionin shqip saktë thotë se “emërimi për postin e Kryetarit të Kosovës kërkon mbështetjen e partisë që ka numrin më të madh të vendeve në Kuvend, ose së paku të njëzet e pesë deputetëve” (Rregulla 16.2).

¹⁷ Zgjedhja e Kryetarit të Kosovës, fillimisht e pritur të mbahet më 9 shkurt, së pari është shtyrë për 13 shkurt e pastaj për 10 shkurt pas diskutimeve të shumta të brendshme, me kërkesë të PDK-së, me arsyetimin se z. Thaçi ishte në udhëtim zyrtar jashtë Kosovës dhe duhej të ishte i pranishëm gjatë zgjedhjes.

duket ishin abstenime. Kryetari i Kuvendit e shpalli z. Sejdiu Kryetar të ri të Kosovës, dhe Kryetari Sejdiu mbajti një fjalë të shkurtër inauguruese, me ç'rast e falënderoi Kuvendin që e nderoi atë duke e zgjedhur në atë post. Kryetari Sejdiu i bëri nderime pararendësit të tij, të ndjerit Kryetarit Rugova, dhe theksoi se njëra nga detyrat e tij si Kryetar do të jetë që ta përparojë unitetin politik dhe ndëretnik.

Neni 9.2.8 i Kornizës Kushtetuese parasheh që “Kryetari i Kosovës zgjedhet nga Kuvendi i Kosovës me votim të fshehtë. . . Kuvendi zgjedh Kryetarin e Kosovës me shumicën e dy të tretave të votave të deputetëve të Kuvendit. Nëse pas dy votimesh nuk arrihet shumica e dy të tretave, në votimin që vijon kërkohet shumica e votave e të gjithë deputetëve.” Të njëjtat kushte parashihihen edhe në rregullat 16.3-5. Votimi është mbajtur në pajtim të plotë me Kornizën Kushtetuese dhe me Rregulloren e punës së Kuvendit. Sipas nenit 9.2.3 të Kornizës Kushtetuese “mandati i Kryetarit të Kosovës zgjat tre vjet.”

Zëvendësimi i Kryetarit të Kuvendit dhe anëtarit të Kryesisë

- Gjatë pjesës së parë të seancës plenare të 10 marsit, Kuvendi e shqyrtoi propozimin e LDK-së për zëvendësimin e z. Nexhat Daci dhe z. Fatmir Sejdiu, si Kryetar i Kuvendit, përkatësisht anëtar i Kryesisë, me z. Kolë Berisha dhe z. Sabri Hamiti. Z. Alush Gashi (LDK) e paraqiti propozimin, duke pohuar se z. Sejdiu është tërhequr nga Kuvendi, kur është zgjedhur Kryetar i Kosovës, dhe se propozimi për zëvendësimin e z. Daci dhe z. Sejdiu e kishte “mbështetjen unanime” të grupit parlamentar të LDK-së. Z. Jakup Krasniqi (PDK) i lexoi me zë rregullat 5.3 dhe 5.5¹⁸ dhe pyeti nëse Kuvendi duhej ta respektonte apo shpërfillte Rregulloren e vetë. Si përgjigje ndaj z. Krasniqit që e kishte lexuar dispozitën për shkarkimin e Kryetarit të Kuvendit, Kryesuesi tha se Kuvendi duhej të votonte për zëvendësimin e jo për shkarkimin. Z. Hajredin Kuçi (PDK) pyeti se pse përdorej fjala “zëvendësim”, meqë Rregullorja përmend vetëm “dorëheqjen” ose “shkarkimin”. Propozimi i LDK-së është miratuar me shumicë votash për, dy vota kundër dhe katër abstenime. Me rastin e emërimit si Kryetar i Kuvendit, z. Berisha mbajti një fjalim të shkurtër, me ç'rast e falënderoi z. Daci për punën e tij të deritanishme dhe e theksoi rëndësinë e bashkëpunimit jopartiak në Kuvend.

Korniza Kushtetuese nuk e rregullon shkarkimin apo zëvendësimin e Kryetarit të Kuvendit apo anëtarëve të Kryesisë, e as që e kanë bërë edhe dy verzionet e para të Rregullores së Kuvendit. Andaj, Kuvendi me rastin e ripunimit të Rregullores në maj të vitit 2005 ka futur dispozitat vijuese: “Kryetari i Kuvendit mund t'i paraqesë dorëheqjen Kuvendit. Aktin e dorëheqjes me shkrim ia dorëzon paraprakisht Kryesisë së Kuvendit. Pas miratimit të dorëheqjes, partia politike ose koalicioni që e ka emëruar ish-kryetarin e Kuvendit, propozon kandidatin për kryetar, në pajtim me rregullën 4 të kësaj rregulloreje. E njëjta procedurë vlen edhe në rastet e dorëheqjes së cilitdo nga anëtarët e Kryesisë. Shkarkimi i Kryetarit të Kuvendit apo anëtarit të Kryesisë bëhet me propozimin e partisë politike apo grupit parlamentar i cili e ka emëruar atë në pajtim me procedurën për emërimin e tyre” (Rregullat 5.3-5.5). Rregulla 4, si dhe nenet 9.1.7-8 të Kornizës Kushtetuese e përshkruajnë procedurën për emërimin fillestar të Kryetarit të Kuvendit dhe tërë Kryesisë së Kuvendit në seancën plenare inauguruese, me ç'rast secili anëtar emërohet nga partia, koalicioni, apo komuniteti/komunitetet etnike i tij/saj përkatës, dhe pastaj Kryesia në tërësi, duke përfshirë Kryetarin e Kuvendit, miratohet me votim formal në Kuvend, me shumicë të thjeshtë. Kjo nënkupton që “shkarkimi” apo “zëvendësimi” i Kryetarit të Kuvendit dhe/ose anëtarit të Kryesisë propozohet nga subjekti përkatës dhe miratohet formalisht nga shumica e thjeshtë e deputetëve të Kuvendit, të cilët janë të pranishëm dhe votojnë. Kjo gjithashtu nënkupton se shkarkimi apo zëvendësimi i një ose më shumë anëtarëve të Kryesisë – ose, siç ndodh në këtë rast, Kryetari i Kuvendit dhe një anëtar i Kryesisë – mund të

¹⁸ Kryetari i Kuvendit mund t'i paraqesë dorëheqjen Kuvendit. Aktin e dorëheqjes me shkrim ia dorëzon paraprakisht Kryesisë së Kuvendit. Pas miratimit të dorëheqjes, partia politike ose koalicioni që e ka emëruar ish-kryetarin e Kuvendit, propozon kandidatin për kryetar, në pajtim me rregullën 4 të kësaj rregulloreje (5.3). Shkarkimi i kryetarit të Kuvendit ose i anëtarit i Kryesisë së Kuvendit, në propozim të partisë politike apo grupit që e ka emëruar, bëhet sipas procedurës së zgjedhjes së tyre (5.5).

miratohet me një votim të vetëm. Votimi për zëvendësimin e Kryetarit të Kuvendit dhe anëtarit të Kryesisë më 10 mars është bërë në pajtim me Rregulloren.

Zgjedhja e Kryeministrit të ri dhe Qeverisë

- Gjatë pjesës së dytë të seancës plenare më 10 mars, Kryetari i sapozgjedhur i Kuvendit Kolë Berisha i dha fjalën Kryetarit të Kosovës Fatmir Sejdiu, i cili i propozoi formalisht Kuvendit z. Agim Çeku për Kryeministër, dhe z. Çeku e paraqiti listën e tij të ministrave dhe zëvendësministrave të propozuar. Kryetari i Kuvendit njoftoi se Kuvendi do ta kishte mundësinë që të debatonte për Qeverinë e re të propozuar para votimit të saj. Përafërsisht 25 deputetë, shumica nga radhët e partive në opozitë, folën gjatë debatit të gjatë mëse se tri orë. Përfaqësuesit e koalicionit qeverisës deklaruan mbështetjen e tyre për z. Çeku dhe kabinetin e tij, derisa përfaqësuesit e opozitës shprehën mosbesimin e tyre se Qeveria e re, me ndryshime minimale përveç Kryeministrit dhe Zëvendëskryeministrit, do të punojë më mirë se Qeveria e kaluar. Shumë deputetë nga opozita u përqëndruan në korrupsionin dhe paaftësinë e supozuar brenda kabinetit qeveritar, derisa të tjerët e kritikuan z. Çeku se e “kishte braktisur misionin e tij për ndërtimin e ushtrisë së Kosovës.” Z. Sokol Bashota (PDK) komentoi se z. Çeku “për vetëm një muaj në radhët e UÇK-së nuk ishte sprovuar në asnjërën nga betejat më të lavdishme të saj.” Znj. Selvije Halimi (PDK) tha se, në kohën kur është duke u përcaktuar statusi i Kosovës, koalicioni duhet të mendojë seriozisht se “çfarë Kryeministri ofron – një Kryeministër vërtet të Kosovës apo një Kryeministër me dyshtetësi.” Z. Hajredin Hyseni (PDK) tha se “Qeveria e mëparshme ka qenë më e dobët në rajon, por të paktën Kryeministri ka folur dhe ka menduar shqip në shtëpi . . . Kryeministri (i propozuar) bën eksperimente me Kosovën, derisa familjen e ka në një vend tjetër.” Z. Nazim Jashari (ORA) e dënoi përdorimin e fyerjeve personale dhe tha se në Kuvend vetëm *puna* e individëve duhet të jetë objekt për kritikë. Pasiqë kishte vazhduar debati për një kohë, z. Fetah Berisha (LDK) bëri vërejtjen se në rendin e ditës të seancës plenare parashihej *votimi* dhe jo *debatimi* i Qeverisë. Kryetari i Kuvendit u përgjigj se debati është e drejtë e deputetëve. Z. Sabri Hamiti (LDK), si përgjigje ndaj kritikave të rënda drejtuar Qeverisë, bëri vërejtjen se Kuvendi ka të drejtë ta shkarkojë Qeverinë nëse do të ishte e nevojshme, dhe nëse Kuvendi nuk i përmbush detyrat e tij kushtetuese për mbikëqyrjen e ekzekutivit, atëherë tërë kritikën e shprehura në atë seancë do të ishin të pakuptimta.

Gjatë debatit, z. Veton Surroi (ORA) dhe z. Ferid Agani (Për Integrim/PD) shprehën zhgënjimin që z. Çeku nuk e kishte paraqitur programin e Qeverisë në Kuvend. Z. Agani tha se grupi i tij parlamentar kishte planifikuar ta bazojë vendimin e vetë në përmbajtjen e programit që do të paraqitej, dhe propozoi që votimi i Qeverisë të shtyhej derisa programi qeveritar t'i vihej në dispozicion Kuvendit. Z. Agani më tutje propozoi që deklarimi për Qeverinë të bëhej me votim të fshehtë, propozim ky që u përsërit më vonë nga z. Gjergj Dedaj (Për Integrim/PLK) dhe z. Ramë Buja (PDK). Znj. Teuta Sahatqija (ORA) poashtu theksoi se propozimi i grupit për Integrim duhej të vëhej në votim. Z. Alush Gashi (LDK) kundërshtoi duke thënë se Qeveritë në të kaluarën gjithmonë janë votuar në mënyrë të hapur. Kryetari i Kuvendit e vëri në votim propozimin e grupit për Integrim për votim të fshehtë të Qeverisë; propozimi është hedhur poshtë me 64 vota kundër, 39 vota për dhe një abstenim. Më pas Kryetari i Kuvendit e thirri Kuvendin që të deklarohet me anë të ngritjes së duarve për Qeverinë, e cila është zgjedhur me 65 vota për, 33 vota kundër dhe pesë abstenime. Kryeministri i ri i Kosovës z. Agim Çeku pastaj mbajti fjalimin inaugurues, në të cilin përmendi përmbushjen e Standardeve, sundimin e ligjit, arsimin, shëndetësinë dhe punësimin në mes të prioritetëve të Qeverisë së tij. Kryeministri Çeku theksoi se “koha e urrejtjes dhe diskriminimit duhet t'i takojë së kaluarës” dhe, duke thënë se dëshironte të tregonte se do të jetë Kryeministër i të *gjithë* kosovarëve, e mbajti një pjesë të fjalimit të tij në gjuhën serbe.

Neni 9.3.8, i Kornizës Kushtetuese parasheh që “pas zgjedhjeve, ose në rast se Kryeministri jep dorëheqje apo nëse vendi i tij mbetet i lirë për arsye të tjera, Kryetari i Kosovës, pas konsultimeve me partitë politike të përfaqësuara në Kuvend, ia propozon Kuvendit një kandidat për Kryeministër. Kandidati i propozuar i paraqet Kuvendit një listë me ministrat e propozuar. Kryeministri bashkë me ministrat zgjidhen nga shumica e deputetëve të Kuvendit.” Andaj, për

ta zgjedhur Qeverinë duhen 61 apo më shumë vota. Rregulla 18.3 parasheh që “Qeveria e Kosovës, e përbërë nga kandidatët për kryeministër, zëvendëskryeministër dhe nga kandidatët për ministra dhe për zëvendësministra, konsiderohet e zgjedhur nëse kandidatët marrin shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit. Mënyrën e votimit për zgjedhjen e Qeverisë e përcakton Kuvendi.” Procedura që është përdorur – duke votuar se cila mënyrë votimi të përdoret dhe vendimi, me shumicë votash, për të votuar me dorë – është në pajtim me Kornizën Kushtetuese dhe Rregulloren e punës.

Rregulla 22.10 parasheh që deputetët nuk duhet të përdorin gjuhë joparlamentare, që definohet si “ofenduese, shpifëse ose kërcënuese; sulme personale ose fyerje; gjuhë e pahijshme; ose që nxit dhunë ndëretnike.” Rregulla 22.11 parasheh që “Kryetari i Kuvendit mund ta urdhërojë një deputet ose ministër, që sipas mendimit të tij ka përdorur gjuhë jo parlamentare, t’i tërheq fjalët e tilla, ose nëse do të jetë e nevojshme merr masa në pajtim me paragrafin 13 të kësaj rregulle.”¹⁹ Situatat, si kjo më lartë, mund të jenë të përshtatshme për ndërhyrjen e Kryetari të Kuvendit.

Interpelanca

- Ministria për Shërbime Publike Melihate Tërmkolli (LDK) i ka dërguar më 28 dhjetor Kryesisë së Kuvendit përgjigjen në interpelancën e dorëzuar nga PDK-ja.²⁰ Në përgjigjen e saj, Ministria Tërmkolli ka pohuar se në pyetjen “Çka ka ndodhur në Ministrinë e Shërbimeve Publike që nga ardhja e znj. Tërmkolli në postin e Ministres?” nuk ka mundur të gjejë “formulimin e saktë të çështjes që mund të ishte lëndë e interpelancës, pasi që pyetja është e përgjithshme.” Ajo pastaj ka përmendur disa të arritura të rëndësishme të ministrisë gjatë vitit të kaluar. Ministria Tërmkolli ka vazhduar në përgjigjen e saj duke thënë se ajo është gjithmonë e gatshme të raportojë para Kuvendit dhe komisioneve të tij, në pajtim me Rregulloren, por ajo argumentoi se interpelanca nuk është hartuar në pajtim me Rregulloren e punës. Duke vazhduar me komentimin e formulimit të pyetjes, ajo tha se konkluzioni i propozuar në mocionin e interpelancës – shkarkimi i Ministres Tërmkolli nga ana e Kuvendit – ishte në kundërshtim me Kornizën Kushtetuese dhe me Rregulloren e punës. Ministria Tërmkolli argumentoi më tutje se nuk ishte dhënë arsyeimi i qëndrueshëm për akuzat e bëra në mocionin e interpelancës. Ajo përfundoi në përgjigjen e saj se interpelanca nuk kishte bazë për shqyrtim, andaj “duhet të refuzohej.”

Përgjigja e Ministres Tërmkolli është përfshirë në rendin e ditës të seancës plenare të 19-20 janarit/14-15 shkurtit. Gjatë paraqitjes së kësaj pike të rendit të ditës, Kryetari i Kuvendit tha se të gjithë deputetët e Kuvendit e kishin marrë me shkrim përgjigjen e Ministres dhe se sipas të gjitha gjasave nuk kishte nevojë për debat “përveç nëse dikush insiston.” Z. Ramë Buja (PDK) tha se PDK-ja nuk kishte kërkuar përgjigje me shkrim apo ligjëratë për formulimin e interpelancave, por që Ministria Tërmkolli t’i përgjigjej gojarisht interpelancës para Kuvendit dhe, nëse ajo dëshironte, t’i sfidonte pohimet e bëra në të.²¹ Z. Xhevat Bislimi (PDK) pyeti lidhur me anulimin e kontratës për renovimin e ndërtesës së mediave “Rilindja”. Kryetari i Kuvendit tha se nuk kishte hapur debat. Ai shtoi se Kryesia planifikon që në të ardhmen t’ia kushtojë orën e parë të secilës seancë plenare pyetjeve për Qeverinë, duke lënë të kuptohej se Ministria Tërmkolli mund të thirrej në një datë të mëvonshme nga cilido deputet i PDK-së për

¹⁹ Rregulla 22.13 thotë: “Në rast të ndonjë parregullsie serioze në Kuvend, Kryetari i Kuvendit mund ta shtyjë seancën në tërësi, ose mund të pezullojë për një kohë të caktuar.”

²⁰ Më 25 tetor, PDK-ja ka dorëzuar një mocion të interpelancës, me nënshkrimet e deputetëve të saj, me të cilin e ftonë Ministrën e Shërbimeve Publike Melihate Tërmkolli (LDK) t’i përgjigjej akuzave për shkeljen e Ligjit për menaxhimin e financave publike, Ligjit për prokurimin publik, dhe Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/36 mbi shërbimin civil në Kosovë. “Lënda” kryesore e interpelancës ishte: “Çfarë ka ndodhur në Ministrinë e Shërbimeve Publike që nga ardhja e znj. Melihate Tërmkolli në postin e Ministres?” Mocioni i interpelancës e akuzon atë se nën udhëheqjen e saj kanë ndodhur “shkarkime masive të shërbyesve civil, gjithmonë me motivacion politik.” Konkluzioni i propozuar në interpelancë ishte që Kuvendi ta shkarkonte Ministrën Tërmkolli. Për shkak të vonësave në Kuvend, mocioni i interpelancës i është dërguar Ministres Tërmkolli në dhjetor. Shiko raportet 09/2005 dhe 10/2005 të Shtyllës së III-të (OSBE).

²¹ Ministria Tërmkolli ishte e pranishme gjatë tërë diskutimit të mocionit të interpelancës, por Kryetari i Kuvendit nuk ka kërkuar prej saj që të fliste.

t'u përgjigjur lidhur me punën në ministrinë e saj. Z. Xhavit Haliti (PDK) theksoi se institucionet e Kosovës janë zotuar për përmbushjen e Standardeve, siç është institucionet demokratike funksionale, andaj kërkoi që Qeveria ta ndërpresë praktikën e shpërfilljes së interpelancave.²² Kryetari i Kuvendit u përgjigj se nëse PDK-ja ishte e pakënaqur, atëherë mund t'ia drejtonte një mocion procedural Komisionit për çështje gjyqësore, legjislative dhe Kornizë Kushtetuese.

Rregulla 25.3 parasheh, siç është pohuar nga Ministrija Tërmmkollli, që mocioni i interpelancës duhet të përmbajë "formulimin e saktë të çështjes që është lëndë e interpelancës", si dhe "konkluzionin që propozohet dhe arsyetimin; emrin dhe mbiemrin e deputetit, që e ka parashtruar interpelancën në Kuvend; dhe nënshkrimet e deputetëve, që e mbështesin interpelancën." Sipas rregullës 25.4, "interpelanca i parashtrohet Kryesisë së Kuvendit. Kryesia e Kuvendit, menjëherë sapo ta ketë marrë tekstin e interpelancës, ia dërgon Qeverisë, që është e detyruar ta shqyrtojë brenda jo më shumë se pesëmbëdhjetë (15) ditësh." Rregulla 25.5 parasheh që "interpelanca vihet në rendin e ditës në afatin prej dhjetë (10) ditësh, pasi të merret përgjigja nga Qeveria . . . Kuvendi nuk mund ta refuzojë vënien e interpelancës për shqyrtim në rendin e ditës, përveç në rast se ajo nuk i plotëson kushtet formale sipas paragrafit 3 të kësaj rregulle."

As Rregullorja e Kuvendit as Rregullorja e Qeverisë²³ nuk i japin rol Qeverisë që të vendosë nëse interpelanca është formuluar ose jo në pajtim me rregullën 25.3. Ngjashëm, rregulla 25.4 kërkon nga Kryesia e Kuvendit që ta dërgojë interpelancën në Qeveri, pa të drejtë që ta bllokojë mocionin mbi bazën e formulimit të parregullt. Vetëm Kuvendi si tërësi mund të sjellë një vendim të tillë, siç parashihet në rregullën 25.5. E njëjta rregullë kërkon që interpelanca të përfshihet në rendin e ditës të seancës plenare "brenda (10) dhjetë ditësh pasi të merret përgjigja nga Qeveria," pa marrë parasysh përmbajtjen e përgjigjes së Qeverisë. Në të ardhmen, kur grupet parlamentare parashtrojnë mocione të interpelancës, do të mund të konsultoheshin më së afërmi me Departamentin e Kuvendit për mbështetje ligjore dhe procedurale në mënyrë që të shmangen rastet në të cilat një mocion për interpelancë, që nuk është i formuluar si duhet, procedohet në Kryesi të Kuvendit dhe në Qeveri, dhe pastaj të refuzohet më vonë nga Kuvendi futja e tij në rendin e ditës të seancës plenare.

Sipas rregullës 25.6-8, "përfaqësuesi i autorizuar i parashtruesve të interpelancës në fillim të debatit ka të drejtë ta arsyetojë atë në lidhje me kërkesën . . . Kryeministri ose ministri të cilit i parashtrohet interpelanca ka për detyrë ta paraqesë dhe të arsyetojë qëndrimin e Qeverisë . . . Deputetët kanë të drejtë të diskutojnë lidhur me çështjen e shtruar në interpelancë në pajtim me dispozitat e Rregullores së punës lidhur me çështjen e shtruar të interpelancës." Kuvendi nuk e ka refuzuar futjen e mocionit të interpelancës në rendin e ditës të seancës plenare. Andaj, Ministria²⁴ është dashur të udhëzohet që t'i paraqesë argumentet gojarisht para Kuvendit, dhe Kuvendi është dashur t'i ipet mundësia që të debatojë për këtë çështje.

4. Qasja dhe pjesëmarrja e barabartë e komuniteteve

- Gjatë shqyrtimit të parë të projektligjit kundër shpifjes dhe fyerjes më 20 janar, z. Džezair Murati (6+/Vakat) bëri vërejtjen se "asnjë përfaqësues nga komunitet tjera" nuk ishte i përfshirë në grupin punues që e kishte hartuar projektligjin dhe shtoi se grupi i tij parlamentar ka kërkuar disa herë që të jenë të përfaqësuar në grupet punuese të Qeverisë. Znj. Nuran Malta (6+/KDTP) gjithashtu komentoj për rëndësinë e përfshirjes së përfaqësuesve të komuniteteve tjera, gjatë shqyrtimit të parë të projektligjit për botimin e teksteve shkollore, mjeteve mësimore, lektyrës shkollore dhe dokumentacionit pedagogjik më 23 shkurt.

²² Shiko raportin 08/2005 të Shtyllës së III-të (OSBE) mbi monitorimin e Kuvendit të Kosovës.

²³ Neni 72 i Rregullores së punës së Qeverisë parasheh që "sa herë që Kuvendi debaton mocionin e votëbesimit të Qeverisë, propozimet për emërim apo shkarkim të ministrave ose interpelancën për punën e Qeverisë, Qeverinë në Kuvend e përfaqëson Kryeministri." Rregullorja e punës e Qeverisë nuk përmend më tej interpelancat.

²⁴ Apo Kryeministri, siç parashihet në Rregulloren e punës së Qeverisë (shiko fusnotën 23).

Vërejtje të ngjashme janë bërë në disa raste në Kuvend.²⁵ Më 8 prill 2005, Kryeministri ka nxjerrë një “Vendim për përfshirjen e ekspertëve në grupet punuese për hartimin dhe vlerësimin e projektligjeve,” i cili parasheh që sekretari i përhershëm i Zyrës së Kryeministrit duhet t’i përfshijë përfaqësuesit e komuniteteve minoritare në grupet punuese për hartimin e projektligjit që është “i rëndësishëm për minoritetet kombëtare apo interesat e tyre” por nuk është e qartë nga teksti se mbi çfarë baze përcaktohet se cilat projektligje janë të rëndësishme për interesat e komuniteteve.²⁶

- Në seancën plenare të 23 shkurtit, z. Sabit Rrahmani (Integrimi/PDAK) e informoi Kuvendin se kishte biseduar me banorët e kampeve të kontaminuara me plumb në Mitrovicë/Mitrovica, prej të cilëve kërkohet që të zhvendosen në një kamp tjetër në afërsi dhe e shprehu shqetësimin e tyre se kontaminimi do të ishte i njëjtë. Z. Rrahmani kërkoi që, në seancën e ardhshme plenare, një përfaqësues i Qeverisë t’i paraqesë arsyet se pse kërkohet nga banorët e kampit që të zhvendosen.

Kërkesa, e paraqitur gojarisht në seancë plenare, duhet të pasohet nga një pyetje formale drejtuar Ministrit përkatës për përgjigje me gojë, në pajtim me rregullën 26.

5. Qasja

Gjatë periudhës raportuese, Shtylla e III-të (OSBE) ka pasur qasje në seancat plenare, në mbledhjet e rregullta të Kryesisë, si dhe në të gjitha komisionet. Shtylla e III-të (OSBE) gjithashtu ka pranuar kopjet e dokumentave të shqyrtuara nga Kuvendi si dhe transkriptin e seancave të kaluara.

6. Transparenca

Radio Televizioni i Kosovës (RTK) ka siguruar transmetimin e drejtpërdrejtë të seancave plenare në fjalë. Më 14 shkurt, pjesa e dytë e seancës plenare nuk është transmetuar drejtpërdrejtë, por më vonë atë mbrëmje, për shkak të transmetimit të pasditës të mbledhjes së Këshillit të Sigurimit të KB-së.

Publikut dhe monitoruesve institucional iu është mundësuar hyrja në seancat plenare. Kuvendi ka web faqen (www.kuvendikosoves.org, www.skupstinakosova.org, www.assemblyofkosovo.org). që përmban detaje biografike të deputetëve të Kuvendit, informacione për strukturën dhe funksionimin e Kuvendit, kopje të ligjeve dhe rezolutave të miratuara nga Kuvendi, si dhe informacione të tjera.

FUND.

²⁵ Shiko raportet 02/2005 dhe 01/2005 të Shtyllës së III-të (OSBE) mbi monitorimin e Kuvendit të Kosovës.

²⁶ Vendimi nr. 041/2005, 8 prill 2005.